

VENDIM
Nr. 306, datë 9.5.2012

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 41, DATË 11.1.2012 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRITERET BAZË, SEKTORËT QË DO TË MBËSHTETEN, SI DHE PËR
MASËN E PËRFITIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN
RURAL, PËR VITIN 2012”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 6 të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural” dhe të nenit 15 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kreu VIII i vendimit nr. 41, datë 11.1.2012 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“VIII. Për informimin e publikut, si edhe për aktivitete të tjera promovuese të përdoren nga ky fond 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë.”.

2. Fondi shtesë prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh të përballohet nga fondet e miratuara, në buxhetin e vitit 2012, për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në zërin “Transferte në buxhetet familjare”.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha